



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 maj 2015
Nr. ref.: RK 793/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KIo2/15

Parashtrues

**Qendra Shoqërore, Kulturore, Sportive, Ekonomike “Pallati i Rinisë”,
Prishtinë**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjytimeve të Dhomës së Posaçme të
Gjykatës Supreme: AC-I.-14-0077-AOOOI, AC-I.-14-0078-AOOOI, AC-I.-
14-0079-AOOOI dhe AC-I.-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Qendra Shoqërore, Sportive dhe Ekonomike në Prishtinë, e përfaqësuar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit, z. Fatmir Gashi, jurist nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS): AC-I.-14-0077-AOOOI, AC-I.-14-0078-AOOOI, AC-I.-14-0079-AOOOI, të dhe AC-I.-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014. Parashtruesi i kërkesës i rithekson si të kontestueshme edhe aktgjykimet SCC-05-0080; SCC-06-0029; SCC-06-0470; SCC-06-0482; SCC-06-0524, të gjitha të 15 tetorit 2009; SCC-04-00 10; SCC-04-0011; SCC-04-0012; SCC-04-0098; SCC-04-0116; SCC-04-0121; SCC-04-0199; SCC-05-0028; SCC-05-0067; SCC-05-0072; SCC-05-0073, të gjitha të 29 tetorit 2009; dhe ASC-09-0084; ASC-09-0101, të 13 shtatorit 2012, për të cilat kishte vendosur Gjykata me Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI23/14, të paraqitur nga i njëjti parashtrues.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të përmendura si më lart të DHPGJS-së, me të cilat parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), dhe me Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut. Me këto aktgjykime parashtruesi urdhërohej që t'ua kompensojë dëmin material 16 (gjashtëmbëdhjetë) paditësve, të shkaktuar nga zjarri në ndërtesën e Qendrës Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike në Prishtinë. Ndërsa me aktgjykimet e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, ankesat e parashtruesit ndaj vendimeve të shkallës së parë ishin refuzuar.
4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të caktojë Masën e përkohshme që të pezullojë përmbarimin e aktgjykimeve të DHPGJS-së derisa të merret vendimi nga Gjykata.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 21.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 54, 55, dhe 56 të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 13 janar 2015, Kryetari, me Vendimin GJR. KIO2/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KIO2/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 19 shkurt 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS-së.

9. Më 14 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 7 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatë edhe një kërkesë, e cila ishte regjistruar si Rasti KI23/14, me po të njëjtat pretendime ankimore dhe shumicën e provave të njëjta në të cilën nuk përfshiheshin vetëm aktgjykimet e fundit të kontestuara të vitit 2014.
11. Përmbledhja e plotë e fakteve, përpos fakteve të reja lidhur me aktgjykimet AC-I.-14-0077-AOOOI AC-I.-14-0078-AOOOI të 15 shtatorit 2014; AC-I.-14-0079-AOOOI, të 15 shtatorit 2014; AC-I.-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014, është trajtuar dhe paraqitur në mënyrë kronologjike në Aktvendimin për papranueshmëri KI23/14, të 3 marsit 2014.
12. Gjykata megjithatë rikujton se çështja bazë e kërkesës, është fakti se ndërmjet vitit 2004 dhe 2005, 16 (gjashtëmbëdhjetë) paditës paraqitën paditë e tyre në DHPGJS-së, duke kërkuar kompensimin e dëmeve nga parashtruesi, për mallrat që ishin brenda depove të marra me qira, të cilat ishin shkatërruar nga zjarri.
13. Me aktgjykimet si në pikën 2 të këtij raporti, DHPGJS-së në vitin 2009 ka aprovuar paditë individuale të paditësve dhe ka akorduar shumën e kompensimit që duhet t`u paguhet paditësve, ndërsa Kolegji i ankesave i DHPGJ-së pas ankesës së parashtruesit në vitin 2012 i ka ndryshuar pjesërisht aktgjykimet, vetëm sa i përket pjesës së shumës së kompensimit duke e zvogëluar atë.
14. Më 18 tetor 2012, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në DHPGJS-së për Gjykatën Supreme, me pretendim për zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale, në aktgjykimet e Kolegjit të Ankesave (ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084).
15. Më 23 tetor 2012, bazuar në propozimin e parashtruesit, Prokurori i Shtetit ka paraqitur në Gjykatën Supreme kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë KMLC. nr. 101/12-1 dhe KLMC. nr. 101/12-2 kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për të gjitha vendimet e DHPGJS-së që lidhen me këtë rast.
16. Më 15 shtator 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka nxjerrë aktvendimet AC-I.-14-0077-AOOOI; AC-I.-14-0078-AOOOI, AC-I.-14-0079-AOOOI, AC-I.-14-0080-AOOOI me anë të të cilave i ka hedhur poshtë si të papranueshme kërkesën për revizion dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
17. Të katër aktvendimet kishin një arsyetim thuajse të njëjtë, ku theksohej:

“Sipas nenit 10 paragrafi 14 i Ligjit nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-se janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër” dhe se “LDHP-ja dhe Shtojca e saj nuk përmbajnë një referim ndonjë mjeti

te jashtëzakonshëm juridik kundër aktvendimeve apo aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit. Mjete të tilla të jashtëzakonshme juridike nuk janë parapare as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 e as me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2008/6”.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon se aktgjykimet dhe aktvendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] lidhur me nenin 7 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] lidhur me nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNJ), nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] lidhur me nenin 8 të (DUDNJ) dhe me nenin 41, par 1 dhe 2, të Kushtetutës [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike].
19. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 21 dhe neni 22, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1. të Ligjit Për Gjykata (ligj nr. 03/L-199), ka kompetence ekskluzive për të shqyrtuar dhe vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike të paraqitura KUNDER vendimeve gjyqësore të formës së prere. Andaj në rastin konkret Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka pasur për obligim që kërkesën për REVIZION dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit, që ta dërgoj se bashku me lenden tek Gjykata Supreme e Kosovës, e jo në të kundërtën të vendos një vendim për të cilin nuk e autorizon ligji në shqyrtimin e saj”.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje që të shqyrtoj kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata do të deklaroj një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

23. Gjykata konstaton se për të gjitha aktgjykimet e DHPGJS-së të vitit 2009 dhe 2012, e që kontestohen prapë nga parashtruesi, ajo tashmë ka dhënë një vlerësim kushtetues dhe me Aktvendimin KI23/14 për papranueshmëri rastin e ka vendosur dhe nuk mund ta rishqyrtojë atë.
24. Në këto rrethana, Gjykata do të vlerësojë çështjen kryesore lidhur me ekzistencën e mjetit juridik ndaj vendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe efektivitetin eventual të tij në dritën e aktvendimeve të fundit të Kolegjit të Apelit të DHPGJ-së, në lidhshmëri me shkeljet e pretenduara nga parashtruesi.
25. Lidhur me sa u tha më lart, Gjykata i referohet Kushtetutës së Kosovës e cila parasheh:

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh ligjin për DHPGJS-së për çështjet që kanë të bëjnë me AKP, Ligji Nr. 04/L-033 i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 20, më 22 shtator 2011, i cili parasheh:

Neni 1, paragrafi 3

“Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 21 të Ligjit nr. 03/L-199 mbi Gjykatat”.

Neni 3, paragrafi 14

“Kolegji i Apelit do të ketë kompetencë ekskluzive të apelit në shkallë të fundit mbi të gjitha apelet nga Aktvendimet apo Aktgjykimet e kolegjeve të specializuara, apo nga cilado gjykatë në lidhje me lëndët apo rastet që i janë referuar më herët një gjykate të tillë nga Dhoma e Posaçme”.

Neni 10, paragrafët 14 dhe 15

“14. Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.

15. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet ose zbatohet për të kufizuar ose për të tentuar për të kufizuar të drejtën kushtetuese të çdo personi për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në pajtim me ligjin dhe rregullat procedurale për një kërkesë të këtillë, për shqyrtimin e kushtetutshmërisë e cilitdo Vendim ose Aktgjykim të lëshuar nga Dhoma e Posaçme ose cilado gjykatë tjetër”.

27. Nga sa u tha më lart, rrjedh se parashtruesi kishte paraqitur kërkesë për revizion ndaj vendimeve të formës së prerë të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe se Prokurori i Shtetit kishte ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj po atyre vendimeve, ndërsa DHPGJS - Kolegji i Apelit këto kërkesa i ka hedhur poshtë si të papranueshme.
28. Gjykata vë në dukje se Kushtetuta e Kosovës në nenin 32 ka përcaktuar “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike... në mënyrën e përcaktuar me ligj*” dhe rikujton se Ligji për DHPGJS për çështjet që lidhen me AKP-në në nenin 10 par. 14 shprehimisht ka paraparë se “*aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër*”.
29. Është tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese, andaj si të tilla janë të implementueshme dhe DHPGJS-së me aktgjykimet e veta vetëm sa e ka rikonfirmuar këtë fakt. Parashtruesi i kërkesës këtë fakt e ka pasur të ditur edhe nga aktvendimi për papranueshmëri i kësaj Gjykate për Rastin KI23/14, kur u trajtua kjo çështje (Shih, Aktvendimi për Rastin KI23/14, par. 31, i 3 marsit 2014 i të njëjtit parashtrues).
30. Gjykata, thekson se për të çmuar efektivitetin e mjetit juridik “*Ekzistimi i mjeteve të tilla juridike duhet të jetë në masë të mjaftueshme e disponueshme jo vetëm në pikëpamje teorike por edhe praktike* (Shih, *Vernillo v. France*, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1991, Seria A nr. 198, st. 27). Ndërsa në rastin konkret, mjeti juridik nuk ishte i paraparë në pikëpamje teorike me ligj, dhe nuk ishte provuar në praktikë dhe nuk mund të prodhonte efekte juridike lidhur me aspektet substanciale të rastit.
31. Në fakt, parashtruesi nuk dëshmoi para Gjykatës me asnjë provë konkrete se Gjykata Supreme ka trajtuar raste të revizionit ndaj vendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në mënyrë që të ishin tregues i trajtimit jo të barabartë të tij para ligjit, dhe në rrethana të tilla Gjykata nuk gjen fakte se procesi gjyqësor ka qenë i padrejtë apo arbitrar, dhe se atij i është cenuar e drejta në mjet juridik.
32. Rrjedhimisht, në kushtet kur parashtruesi nuk arsyeton mjaftueshëm shkeljet e pretenduara, Gjykata nuk mund të gjejë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenet 6 e 13 të KEDNJ-së.
33. Për më tepër sa i përket pretendimit të shkeljes së nenit 54 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesit iu mundësua “mbrojtja gjyqësore e të drejtave të tij” sepse një gjykatë e themeluar me ligj dhe në procedura të parapara me ligj i vlerësoi ankesat e tij, dhe nxori vendimin përfundimtar.

34. Duke marrë parasysh faktin se sipas nenit 1 të Ligjit për DHPGJS-së ajo është pjesë e Gjykatës Supreme, dhe duke marrë për bazë edhe specifikat e saj të veçanta në funksionimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe procedurat të cilat zhvillohen në këtë institucion gjyqësor, Gjykata nuk gjen se me aktvendimet me të cilat janë hedhur poshtë Revizioni dhe Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë të jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, DUDNJ dhe KEDNJ.
35. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij.
36. Prandaj, kërkesa është qartazi e papabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

37. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“të merr vendim për lejimin e masës së përkohshme deri në Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të kontestuara, në mënyrë që të shmangë pagesën e kompensimit nga ana e parashtruesit në shumën e caktuar nga DHPGJS, pasi që kjo shumë është shumë e madhe dhe e papërballueshme, duke marrë parasysh se tashmë janë nxjerrë urdhra për përmbarrim nga përmbarruesit privat”*.
38. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *“përmbarrimi i aktgjykimeve të lartcekura do t'i shkaktojë parashtruesit të kërkesës vështirësi financiare dhe mund të vijë edhe deri te privatizimi i ndërmarrjes, nëse nuk lejohet masa e përkohshme”*.
39. Në mënyrë që Gjykata të lejojë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, është e nevojshme të vërtetohet se:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të riparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme.

(...)

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

40. Siç u cek më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e Masës së përkohshme. Prandaj refuzohet kërkesa për Masë të përkohshme.


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 18 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani